

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA E MAMUSHËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	626-26-4236-1-2-1
Nr i brendshëm	626-26-005-1-2-1

Sa i përket tenderit për: **“FURNIZIMI ME BARËRA PËR QKMF-n NË MAMUSHË”**.

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

MEDPLUS SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Lebanë, Rr. Pranvera e Lirisë, p.n

(Adresa)

Prishtinë

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+38344640420

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Jeton Prenaj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)


medplusks@gmail.com

(Adresa elektronike)

06.07.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) (Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi për Kontratë: 04.06.2026

Data e hapjes së ofertave: 25.06.2026

Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 01.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Të nderuar ne me dt.01.07.2026 përmes platformës elektronike e-prokurimi kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku anuluar aktiviteti i prokurimit, me arsyetimin si më poshtë:

Bazuar në rrethanat e krijuara pas hapjes së Ofertave, konforma nenit 43 paragrafi 43.5 pika (i) të RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi.

Gjithashtu autoriteti kontraktues ka bashkangjitur tek njoftimi mbi vendimin e AK-së edhe një vendim, i cili përmban arsyetimin për anulim të procedurës si në vijim:

Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Mamushës, me datë 04.06.2026 ka shpallur njoftimin për kontratë me titull: "FURNIZIMI ME BARËRA PËR QKMF-n NË MAMUSHË" me nr. të prokurimit 626-26-4236-1-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-26-005-1-2-1. Pas njoftimit për kontratë, dosjen e tenderit e kanë shkarkuar (7) Operator Ekonomik, ndërsa tenderin e ka dorëzuar vetëm njëri (2) prej tyre, ku bazuar në rrethanat e krijuara pas hapjes së Ofertave, konform nenit 62 paragrafi 1 pika 1.1e LPP-s dhe nenit 43 paragrafi 43.5 pika (i) të RREGULLORES NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi.

Andaj duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ju sqarojmë se arsyetimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar.

Autoriteti kontraktues e ka arsyetuar anulimin e aktivitetit të prokurimit vetëm duke cituar nenin 43 paragrafi 43.5 pika (i) të Rregullores nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke deklaruar se *"një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo parandalohet përmes një ndryshimi"*. Pra AK-ja tek njoftimi mbi vendimin e saj, askund në asnjë pjesë të vendimit nuk e ka specifikuar se cila është kjo shkelje që AK-ja po i referohet dhe përse e njëjta nuk mund të korrigjohet.

Dispozita e lartcekur nuk i jep autoritetit kontraktues të drejtën që aktivitetin e prokurimit ta anulojë vetëm duke dhënë një arsyetim kaq të mangët, por për zbatimin e kësaj dispozite duhet të ekzistojë një shkelje konkrete, e identifikuar dhe e arsyetuar, ndërsa vendimi duhet të përmbajë sqarime të mjaftueshme se cilat kushte janë plotësuar të cilat janë të përcaktuara në nenin 43 paragrafi 43.5 pika (i). Në rastin konkret, autoriteti kontraktues nuk ka mundur të argumentoj me fakte konkrete asnjë shkelje konkrete që ka ndodhur dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim që do të dëshmonte se janë plotësuar kushtet për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Për më tepër, autoriteti kontraktues nuk ka shpjeguar se përse shkelja e pretenduar nuk mund të korrigjohet ose parandalohet me ndonjë veprim tjetër procedural, siç kërkohet shprehimisht nga dispozita në të cilën është mbështetur. Në mungesë të një arsyeimi të tillë, nuk mund të konstatohet se janë përmbushur kushtet ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Andaj vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit është i pabazuar, pasi që mbështetet vetëm në citimin e dispozitës ligjore, pa u provuar ekzistimi i rrethanave konkrete që e bëjnë të zbatueshme atë dispozitë në këtë procedurë.

Gjithashtu edhe arsyeimi i dhënë në vendimin e drejtorit të drejtorisë së prokurimit ku ka theksuar se dosjen e tenderit e kanë shkarkuar shtatë (7) operatorë ekonomik, ndërsa ofertë kanë dorëzuar vetëm dy (2) operatorë ekonomik, sqarojmë se ky arsyetim është i paqëndrueshëm, pasi numri i operatorëve ekonomikë që shkarkojnë dosjen e tenderit nuk paraqet ndonjë bazë për anulimin e aktivitetit të prokurimit, sepse fakti që një operator ekonomik e shkarkon dosjen nuk nënkupton se ai është i obliguar të dorëzojë ofertë.

Për më tepër, drejtori i prokurimit nuk ka sqaruar se çfarë lidhje ka ky fakt me vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe prandaj arsyeimi tek numri i operatorëve ekonomik që kanë shkarkuar dosjen dhe atyre që kanë dorëzuar ofertë nuk mund të konsiderohet arsyetim për anulimin e procedurës, pasi që nuk tregon asnjë dëshmi konkrete që janë përmbushur ndonjëra nga kushtet e përmendura tek neni 43 dhe 43.5 i RRPP-së.

Kur kemi parasysh të gjitha faktet e lartcekura kuptohet qartë që autoriteti kontraktues ka anuluar aktivitetin e prokurimit, pa ndonjë bazë ligjore me qëllim që të mos na rekomandoj për kontratë neve si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Mbi këtë bazë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së.

Gjithashtu, anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43.5 dhe 43.7 të RRPPNr.001/2022, pasi që nuk janë plotësuar asnjëra prej kushteve të përcaktuara në këto dispozita.

Neni 43.5 i RRPP Nr.001/2022 i ka parashikuar kushtet që duhet të plotësohen për anulim, si më poshtë:

43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

- a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;*
- b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;*
- RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK*
- c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);*
- d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;*
- e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;*
- f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;*
- g. asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;*
- h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;*
- i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;*
- j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose*
- k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.*

Duke pasur parasysh këtë vlerësim konsiderojmë se kemi trajtim jo të barabartë të kompanisë tonë dhe diskriminim në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Po ashtu nuk është marrë në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerrni:

VENDIM

- I. **APROVOHET**, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE **MEDPLUS SH.P.K**,
- II. **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në **RISHQYRTIM** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

8. Dëmet materiale

Përshekruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA E MAMUSHES

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	626-26-4349 -5-1-1
Nr i brendshëm	626-26-006-511

Sa i përket tenderit për:

Ndertimi dhe renovimii ndriqimit publik rruget -Cumhuriyet-Bahcelik-Asker-Kultur-Pasa-Lika-Torazhda dhe Demirci

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

TONI INGJINJERING SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Llapushnik, Magjistralka, M9, Glllogoc
(Adresa)

Drenas (Glllogoc)
(Vendi)

13050
(Kodi postar)

+383 44 249 730
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Malush Krasniqi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

toni.ingjinjering@hotmail.com

(Adresa elektronike)

22.06.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkëngjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim: N/A

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti kontraktues Komuna e Mamushes, me date 04.06.2026 /15.06.2026 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: **Ndertimi dhe renovimii ndriqimit publik rruget -Cumhuriyet-Bahcelik-Asker-Kultur-Pasa-Lika-Torazhda dhe Demirci**

1. Procedurë e hapur,
2. Kontrate publike,
3. Punë, Vlerë e mesme
4. Vlera e parashikuar e kontratës 195,000.00 euro
5. Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi me i ulte i tenderit të përgjegjshëm,

Afati i fundit për dorëzim të tenderëve, ka qen me date 30.06.2026 ora:14:00,
Vendi: Zyra e Prokurimit

Me date 15.06.2026 është publikuar ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: **Ndertimi dhe renovimii ndriqimit publik rruget -Cumhuriyet-Bahcelik-Asker-Kultur-Pasa-Lika-Torazhda dhe Demirci**

Bashkëngjitur ne këtë titull të këtij njoftimi kemi terhek dosjen e tenderit permes E-prokurimi

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nuk është apliku

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☐

Jo

☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Të pa kënaqur me kriteret e AK- Autoriteti kontraktues – Komuna e Mamushes dhe në pajtim me nenin 108A të LPP-së parashtrojmë kërkesë për rishqyrtim kundër; Kërkesave diskriminuese mbi mundësitë teknike dhe profesionale 9.1 & 9.2: Pas pranimit të dosjes nga platforma e-prokurimi dhe analizimit të saj, ne si OE të interesuar ne bazë të nenit 4.1.26 të LPP-se, për të marrë pjesë në këtë procedure, kërkojmë sqarime shtese për 80% të kriterëve të cilat mendojmë se janë diskriminuese, të pa drejta dhe të pa nevojshme lidhur me aktivitetin relevant të prokurimit në kundërshtim të plotë me nenin 1, pika 1; 2 dhe 3; nenin 6, pika 1, nenin 7, pika 1; 2 dhe 6; neni 28, pika 2 dhe 10, si dhe Neni 69 paragrafi 6.4 të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës në fuqi.

Kriteret në vijim për të cilat kërkojmë sqarime shtese janë të kundërligjshme dhe duhet larguar nga kriteret e përzgjedhjes sepse, mendojmë se janë diskriminuese, të pa drejta dhe të pa nevojshme me aktivitetin relevant të prokurimit (ne bazë të natyrës së punëve dhe parametres së dhënë në dosjet e tenderit, që dote kryhen në kontratë 80% të tyre janë diskriminuese) të cilat po cekim si fakte dhe argumente.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne si palë e interesuar të marrim pjesë në tenderin e lartë cekur nga Komuna e Istogut, Kërkojmë që Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale 9.1 & 9.2: të cilat mendojmë se janë diskriminuese dhe në kundërshtim me Nenin 69 të LPP-së. Kërkesat për të cilat mendojmë dhe jemi të bindur se janë kufizuese, të përshtatura dhe në kundërshtim me Nenin 69 të LPP-së, të cilat duhet të korigjohen, janë:

Kërkesa 1: Lista e referencave
Kërkesa 2: Stafi Profesional
Kërkesa 3: Stafi teknik profesional dhe
Kërkesa 4: Lista e Pajisjeve

Kërkesa 1: Evidenca 1 - Pasqyrat e qarkullimit financiar të kompanisë, të shoqëruara me

qarkullimi financiarë nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorzuara në Administratën Tatimore të Kosovës. si dhe pasqyrat e audituara nga një kompani ose auditor i licencuar për tri vitet e fundit 2023,2024,2025.

Kerkesa jon është se nga kjo ti largohet pjesa: si dhe pasqyrat e audituara nga një kompani ose auditor i licencuar për tri vitet e fundit 2023,2024,2025 .Kjo pra duhet largu si kriter i perzgjedhjes sepse mjafton deklaratat tatimor.kerkesa e cekur ne fjalë është diskriminuese,ne kundërshtim me vlerën e kerkuar për tri vitet e fundit që është kërku 390,000.00e, për të cilën vlerë nuk e parasheh ligji i prokurimit të kerkohet.-dmth pjesa e fjalisë si dhe pasqyrat e audituara nga një kompani ose auditor i licencuar për tri vitet e fundit 2023,2024,2025. Te largohet si kriter.

Kërkesa 2. Për Stafin Profesional;pika b) Nji inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë së paku 5 vite përvojë pune i qertifikuar për efikasitet të energjisë. Dhe nën pikën c) Inxhinier i ndërtimtarisë menagjiomi i ndërtimtarisë dhe teknologjisë së paku 3 vite përvojë pune. Ket kërkesë e keni komuflu duke kriju një monstër të këtyre inxhinjerëve të pa nevojshme për këto aktivitete të prokurimit prandaj:

-Kerkoi që kjo kërkesë të largohet ose të kerkohet vetëm inxhinjer i ndërtimtarisë e jo duke ishtu zanatë të ndryshme të pa nevojshme.

Kerkesa 2 pika d) Te largohet puntori i qertifikuar si drenazher-arsyja është sepse as një pozicion në paramasën e dhënë nuk e kemi që ka të bëjë me drenazhim të ndonjë paisje,prandaj kjo kërkesë është e pa nevojshme për këto aktivitete të prokurimit prandaj:

Kerkoi që kjo kërkesë të largohet

Kerkesa nr 3. OE duhet të jetë i qertifikuar dhe i paisur me këto standarde.

Kjo kërkesë sipas natyrës së projektit nuk është e arsyeshme për disa ISO standarde të cilat janë;

Te tëpërta dhe si kërkesë diskriminuese janë këto ISO: ISO BS PAS 99 2012 -kjo kërkesë për këto ISO standarde është e tëpërt sepse kjo aplikohet në fabrikë ku ka të bëjë me ndonjë prodhim të materjaleve nga metali, ndërsa në paramasën e dosjes së tenderit nuk posedon as një pozicion që kerkohet: prodhimin,furnizimin dhe vendosja e një materjali,por në secilin pozicion thuhet: Furnizimi dhe vendosja e xxxxx materjalit. prandaj kjo kërkesë është e pa nevojshme për këto aktivitete të prokurimit dhe:

Kerkoi që kjo kërkesë të largohet

ISO 39001 2012- Edhe kjo kërkesë është e pa nevojshme sepse në nuk jem të autorizuar me menagju sistemin e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor. Për arsye se janë organet kompetente për këto punë, që janë organet e rendit apo policia rrugore. prandaj kjo kërkesë është e pa nevojshme për këto aktivitete të prokurimit prandaj:

Kerkoi që kjo kërkesë të largohet.

Kerkesa 4.Keni kërkuar 4 kamioneta me korp, dhe e keni cekë -Përshkak të vendit të pa përshatshëm për vendosje të skeleve,kompania duhet të ketë platform (korpë) vetëlevizëse e cila duhet të jetë e gjerë 1m, e lartë max. 2m dhe gjatësi e ngritjes min. 14m -1 copë.

-Kjo kërkesë është pranueshme sepse sipas përshkrimit tuaj duke i përcaktuar pjesët e kësaj

paisje me dimensione te cekura, kjo ban me ditë se as nuk keni kur far arsye qe te vendoset kjo paisje si kerkesë, sepse jo qe as pak nuk mundesh ta perdorsh ket paisje per natyren e kti projekti por është edhe barrë per qdo OE qe e aplikon ket paisje.

Kjo paisje aplikohet per vende te hapura te sheshta e me radhë. Ne si OE e njofim qytetin e mamushes dhe ato fjali qe jeni arsytu nuk qendrojn. Kjo kerkesë është e pa nevojshme per ket aktivitet te prokurimit prandaj:

Kerkoi qe kjo kerkesë te largohet

-Kërkesa mbi mundësitë teknike dhe profesionale qe ju si AK keni kërkuar, janë në kundërshtim të plotë me nenin 28, pika 2 dhe 10 e LPP-se, ngase Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv, por AK i juaj nuk ka përfshirë një projekt apo elaborat se cilat punë sipas paramases së dhëne do të përfundohen në te ardhmen, për me tepër këto kërkesa janë diskriminuese sepse Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Per Autoriteti kontraktues është veçanërisht e ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Kto kritere te kti AKTIVITETI TE PROKURIMIT NUK JAN VENDOS ME KERKESEN E NJISIS KERKUESE APO DREJTORISE QE MENAGJON KET KONTRATË, NUK QENDRON MBRAPA KTYRE MANIPULIMEVE. (kta deklarojn se ne jemi qe sa me par te vazhdojm punet e ndriqimit te rrugve sepse kemi kerkesa nga qytetaret qe nji herit jan edhe taksa pagues te rregullt per shtetin). Ne ketë rast lind pytja kush i vendos kto kritere te pa nevojshme dhe diskriminuese dhe per qfar arsye i ban kto qe per nji interes te nji apo x personi te bahen kto favore e duke lën anash transparencen e taksa pagusve e cila duhet te menagjohet ne menyre korekte, qe kto punë te kryhen sa me mir dhe nji kosto mbrenda suazave te qmimeve ne treg, e qe kjo arrihet kur ju jepet mundsia qe te marrin se paku 3 e me shum OE ne ofertim.

-Nga AK -Zyra e prokurimit ti merr hapat e duhur qe ti largoi te gjitha ato qe i ceka deri me tash por edhe ato nese e din qe jan te teperta per ket projekt, lete vendoset stafi punues dhe mekanizmi ne bazë te natyres se projektit qe ne ket rast e kini vendosja e ndriqimit publik.

Duke unisur nga kto AK -Zyra e prokurimit ka synim qe paraja publike te mos keq perdoret por te shkoji ne ato vende- ku gjen zbatim ne infrastruktur, kanalizim, ndriqim etj. per te miren e popullates me nji kosto te perballushme te tregut e kjo arrihet qe te ket numer sa me shum te OE pjesëmarrs Ne ofertim sepse krijohet mundsia me zgjedhë OE me te favorshe ne ofertë.

Kërkojmë nga ju qe ta riktheni ketë dosje ne verifikim te ktyre kritereve te cekura me lart (te largohen), dhe ti vendosni kriteret ne bazë te natyres se tenderit sipas krpp, e qe mos te ka nevoj per ankesa te metejme. Sepse nese e njejtja perseritet ne dote vazhdojm proceduren e metejm per kto parregullsi qe i krijohen ne favore personale, dhe mandej landa dote shkoi ne OSHP e me radhë do vazhdoi edhe ne istitucionet tjera.

Ju njoftoi se ne jemi kompani per punet e ksaj natyre me staf profesional dhe mekanizem adekuat per kto pun qe është shpall nga kjo komunë,por me kto kriteret te vendosura te pa nevojshme po i favorizoni kompanit qe mirren me punë tjera qe dmth. jasht natyres st kti projekti qe është shpallur .

Prandaj këto kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale te parashtruara nga ana juaj, janë të pa nevojshëm, jo relevante me aktivitetin e prokurimit, diskriminues dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-se, te cekura me lartë, sepse këto kriteret diskriminuese kufizojnë konkurrencën e hapur dhe te lirë për shumë operator ekonomik te cilët kanë aktivitet primar punët e kësaj natyre.

Kshtu qe kërkojmë qe kërkesat e cekura me lartë ti largoni në mënyrë që vetëm ato të cilat janë relevante me aktivitetin dhe të mbështetura në dispozita ligjore të LPP-se, dhe vetëm ato te cilat koordinohen me paramasen dhe natyrën e këtij projekti qe do te realizohet. Në të kundërtën në pajtim me kërkesat LPP-së do të vazhdojmë me procedurat e ankimimit në shkallë të tjera.

Përfundim:

Kërkojmë nga AK, **KOMUNA E MAMUSHES**, që:

- ✓ Të aprovoj Kërkesën për rishqyrtim të bazuar;
- ✓ Të anuloj njoftimin per kontratë
- ✓ Te vendosen kriteret ne perputhshmeri me natyren e projektit te kerkesa mbi mundsin teknike dhe profesionale,te cilat kriteret jan prezente ne kontratat paraprake te ksaj natyre.
- ✓ Te kerkohet stafi profesional qe i perket elektroteknikes apo natyres se punimeve.
- ✓ Te kerkohet mekanizmi qe hyn drejt perse drejti ne realizimin e kti projekti e jo me pas paisje te pa nevojshme veq ne letra,a zbatimi ityre nuk realizohet sepse ska mundsi.

Mbetemi me shpresë se Kërkesa për Ri-shqyrtim do të shqyrtohet pozitivisht.

Me respekt -**M. Krasniqi** -Perfaqses ne kompanin **Toni ingjinjering sh.p.k**

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzime administrative. Shpenzimet e ankimimit 200 €

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çikis - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
02 No.Nr.	91-26
Tarih/Dt.	30.06.2026



Referenca : 626-26-4349-5-2-1

Në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Rregullave dhe udhëzuesit të Prokurimit Publik-NDRYSHIM / PLOTESIMIT të Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik A01 neni 43 pika 43.6 dhe në bazë të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave të rregullores së Prokurimit Publik neni 4 paragrafi 4.1 pika b dhe nenit 7 paragrafi 7.1 a), bie këtë :

V E N D I M

I

Hudhet e pabzuar „Kërkesa për Rishqyrtim e Operatorit Ekonomik N.N.P Toni Labinot Krasniqi B.I nga Negrovci Komuna e Glllogovcit ” e parashtruar me datën 28.06.2026 për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-26-4349-5-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-26-06-5-2-1 me titull "Ndertimi dhe renovimi i ndriqimit publik rruget Kisla- Cumhuriyet-Bahcelik-Huriyet-Asker-Kultur-Pasa-Lika- Torazhda dhe Demirci"

II

Mbetet në Fuqi Njoftimi për kontratë i korigjuar me datë 24.06.2026 ,

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Pretendimet e dhena jane te korrigjuara dhe Arsyetuara ne vendimin e dates 25.06.2026 ,
ne kerkesen per Rishqyrtim te bere nga Toni Injineri SHPK Glllogovc

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë pranë Organit
Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas vendimit të
lëshuar nga autoriteti kontraktues bazuar ne nenin 109 te LPP

Me 30.06.2026

Në M a m u s h ë

Abaz Foniqi Drejtor i Drejtorisë së Prokurimit
Komuna e Mamushës



KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA E MAMUSHËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	626-26-4349-5-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	N.N.P "TONI"
NUI	810254532
Adresa	NRGROFC
Vendi	GLLOGOC
Kodi postar	13050
Numri Telefonit	044/411421
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	LABINOT KRASNIQI
Adresa elektronike	NEGROFC
Data e parashtrimit të kërkesës	28.06.2026

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-i
Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Autoriteti kontraktues Komuna e Mamushes, me date 04.06.2026 /15.06.2026/ 25.06.2026 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: Ndertimi dhe renovimii ndriqimit publik rruget -Cumhuriyet-Bahcelik-Asker-Kultur-Pasa-Lika-Torazhda dhe Demirci

1. Procedurë e hapur,
2. Kontrate publike,
3. Punë, Vlerë e mesme
4. Vlera e parashikuar e kontratës 195,000.00 euro
5. Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi me i ulte i tenderit të përgjegjshëm,

Afati i fundit për dorëzim të tenderëve, ka qen me date 07.07.2026 ora:14:00,
Vendi: Zyra e Prokurimit

Me date 15.06.2026/25.06.2026 është publikuar ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: Ndertimi dhe renovimii ndriqimit publik rruget -Cumhuriyet-Bahcelik-Asker-Kultur-Pasa-Lika-Torazhda dhe Demirci

Bashkëngjitur në këtë titull të këtij njoftimi kemi terhek dosjen e tenderit permes E-prokurimi

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Të pa kënaqur me kriteret e AK- Autoriteti kontraktues – Komuna e Mamushes dhe në pajtim me nenin 108A të LPP-së parashtrojmë kërkesë për rishqyrtim kundër;

Kerkesave diskriminuse mbi mundësitë teknike dhe profesionale 9.1 & 9.2:

Pas pranimit të dosjes nga platforma e-prokurimi dhe analizimit të saj, ne si OE të interesuar në bazë të nenit 4.1.26 të LPP-se, për të marrë pjesë në këtë procedure, kërkojmë sqarime shtese për 60% të kriterëve të cilat mendojmë se janë diskriminuese, të pa drejta dhe të pa nevojshme lidhur me aktivitetin relevant të prokurimit në kundërshtim të plotë me nenin 1, pika 1; 2 dhe 3; nenin 6, pika 1, nenin 7, pika 1; 2 dhe 6; neni 28, pika 2 dhe 10, **si dhe Neni 69 paragrafi 6.4** të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës në fuqi.

Kriteret në vijim për të cilat kërkojmë sqarime shtese janë të kundërligjshme dhe duhet larguar nga kriteret e përzgjedhjes sepse, mendojmë se janë diskriminuese, të pa drejta dhe të pa nevojshme me aktivitetin relevant të prokurimit (në bazë të natyrës së punëve dhe parametres së dhënë në dosje të tenderit, që dote kryhen në kontratë 60% të tyre janë diskriminuese) të cilat po i cekim si fakte dhe argumente.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne si palë e interesuar të marrim pjesë në tenderin e lartë cekur nga Komuna e Mamushes, Kërkojmë që Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale 9.1 & 9.2: të cilat mendojmë se janë diskriminuese dhe në kundërshtim me Nenin 69 të LPP-së.

Kërkesat për të cilat mendojmë dhe jemi të bindur se janë kufizuese, të përshtatura dhe në kundërshtim me Nenin 69 të LPP-së, të cilat duhet të korrigjohen, janë:

Kërkesa 2: Stafi Profesional

Kërkesa 3: Stafi teknik profesional dhe

Kërkesa 4: Lista e Pajisjeve

Kërkesa 2. Për Stafin Profesional; pika b) Nji inxhinier i diplomuar i ndertimtarisë së paku 5 vite përvoj pune i qertifikuar për efikasitet të energjisë. Dhe nën pikën c) Inxhinier i ndertimtarisë së menagjimi i ndertimtarisë dhe teknologjisë së paku 3 vite përvoj pune.

Ne keto dy kërkesa b dhe c keni kerku inxh.te ndertimtaris,ku kjo kërkesë te ktyre inxhinjerve është pa nevojshme per ket aktivitet te prokurimit prandaj:

-Kerkoi qe kjo kërkesë te largohet ose te kerkohet vetem ingjinjer i ndertimtaris e jo duke ishtu profesione te cilat nuk i pershtaten kti aktiviteti te te prokurimit prandaj duhet larguar njeri prej termeve te pa nevojshme.

Kërkesa nr 3. OE duhet të jet i qertifikuar dhe i paisur me kto standarde.

Kjo kërkesë sipas natyres se projektit nuk është e arsyeshme per disa ISO standarde te cilat jan; Te teperta dhe si kërkesë diskriminuse jan kto ISO: ISO BS PAS 99 2012 -kjo kërkesë per ket iso standarde është e tepert,separ nuk e kini ba kërkesen te kjart,perveq ksaj kjo duhet largu nga kriteri per arsye se nuk gjen kurfar zbatimi ne implementim te ksaj kontrate. Lind pytja qka nen kuptojm me sisteme te menagjimit te integruar.

prandaj kjo kërkesë është e pa nevojshme per ket aktivitet te prokurimit dhe:

Kerkoi qe kjo kërkesë te largohet per arsye se vetem ban kufizimin e OE per te marr pjesë ne ofertim,dhe mduket qe ky është edhe synimi i juaj.

ISO 39001 2012- Edhe kjo kërkesë është e pa nevojshme sepse ne nuk jem te autorizuar me menagju sistemin e menaxhimit te sigurisë se trafikut rrugor. Per arsye se kemi puntor te qertifikuar per ket lami. prandaj kjo kërkesë per kompani është e pa nevojshme per ket aktivitet te prokurimit kur kemi staf per ket lami keshtu kerkoi qe edhe kjo kërkesë te largohet.

Kërkesa 4.Ne fillim para korigjimit keni kerkuar 4 kamioneta me korpë, dhe e keni cekë - Përshkak të vendit te pa pershtatshem per vendosje te skeleve,kompania duhet te ket plotëformë (korpë) vetëlevizëse e cila duhet te jet e gjerë 1m, e lartë max. 2m dhe gjatsi e ngritjes min. 14m -1 copë.

Ju keni vepru ne kundershtrim me kërkesen por ne kundershtrim edhe me kriteret apo mekanizmat punues se cilet jan me adekuat per ket projekt prandaj keni nderhy dhe keni largu automjetet speciale per ke lami dhe keni leju qe te jet prezent nji platform qe gjoja po i zavendson skelet (kshtu qe kti projekti keni dha ransi se si do te zavendsohen skelet,por lind pytja cilat skele ku jan te vendosura skelet) kjo asht qesharake dhe skandaloze.

Ju njoftoi se kjo paisje nuk aplikohet te punet e rregullimit te ndriqimit rrugor,prandaj kerkoi qe te rikthehen mekanizmat qe jan praktik per kto pun e te largohet paisja ne fjal sepse edhe kërkesa asht e manget per ket paisje duke aludu pjeset e saja me meter e me centimeter,prandaj **Kerkoi qe kjo kërkesë per ket paisje me kto dimensione te largohet per arsye se vetem ban kufizimin e OE per te marr pjesë ne ofertim,dhe mduket qe ky është edhe synimi i juaj.**

-Kërkesa mbi mundësitë teknike dhe profesionale që ju si AK keni kërkuar, janë në kundërshtim të plotë me nenin 28, pika 2 dhe 10 e LPP-se, ngase Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv, por AK i juaj nuk ka përfshirë një projekt apo elaborat se cilat punë sipas paramasës së dhëne do të përfundohen në të ardhmen, për më tepër këto kërkesa janë diskriminuese sepse Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifi kimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Per Autoriteti kontraktues është veçanërisht e ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

-Nga AK –Zyra e prokurimit kerkojm qe ti merr hapat e duhur qe ti largoi te gjitha ato qe i ceka deri me tash por edhe ato nese e din qe jan te teperta per ket projekt,lete vendoset stafi punues dhe mekanizmi ne bazë te natyres se projektit qe ne ket rast e kuni vendosja e ndriqimit publik.

Duke unisur nga kto AK –Zyra e prokurimit ka synim qe paraja publike te mos keq perdoret por te shkoji ne ato vende- ku gjen zbatim ne infrastruktur,kanalizim,ndriqim etj. per te miren e popullates me nji kosto te perballushme te tregut e kjo arrihet qe te ket numer sa me shum te OE pjesëmarrs Ne ofertim sepse krijohet mundsia me zgjedhë OE me te favorshe ne ofertë.

Kërkojmë nga ju që ta riktheni këtë dosje në verifikim të ktyre kritereve të cekura më lart (te largohen), dhe ti vendosni kriteret në bazë të natyres së tenderit sipas krpp, e që mos të ka nevoj për ankesa të metejme. Sepse nese e njejta perseritet ne dote vazhdojm proceduren e metejm per kto parregullsi qe i krijohen ne favore personale, dhe mandej landa dote shkoi ne OSHP e me radhë do vazhdoi edhe ne istitucionet tjera.

Prandaj këto kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale të parashtruara nga ana juaj, janë të pa nevojshëm, jo relevante me aktivitetin e prokurimit, diskriminues dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-se, të cekura më lartë, sepse këto kritere diskriminuese kufizojnë konkurrencën e hapur dhe të lirë për shumë operator ekonomik të cilët kanë aktivitet primar punët e kësaj natyre.

Kshtu që kërkojmë që kërkesat e cekura më lartë ti largoni në mënyrë që vetëm ato të cilat janë relevante me aktivitetin dhe të mbështetura në dispozita ligjore të LPP-se, dhe vetëm ato të cilat koordinohen me paramasën dhe natyrën e këtij projekti që do të realizohet. Në të kundërtën në pajtim me kërkesat LPP-së do të vazhdojmë me procedurat e ankimimit në shkallë të tjera.

Përfundim:

Kërkojmë nga AK, **KOMUNA E MAMUSHES**, që:

- ✓ Të aprovoj Kërkesën për rishqyrtim të bazuar;
- ✓ Të anuloj njoftimin për kontratë

- ✓ Te vendosen kriteret ne perputhshmeri me natyren e projektit
- ✓ Te kerkohet stafi profesional qe i perket elektroteknikes apo natyres se punimeve.
- ✓ Te kerkohet mekanizmi qe hyn drejt perse drejti ne realizimin e kti projekti.

Mbetemi me shpresë se Kërkesa për Ri-shqyrtim do të shqyrtohet pozitivisht.

Me respekt -**Labinot Krasniqi** –Drejtor ne kompanin **N.N.P “Toni”**

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzime administrative. Shpenzimet e ankimimit 350 €

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.